

**KUR PUNONJËSIT SHËNDETËSOR
JANË TË SËMURË,
KUJDESI PËR PACIENTIN
NUK DO JETË I RREGULLT**

Mungesa e personelit gjatë sezonit të gripit mund të ketë efekte negative në kujdesin ndaj pacientëve dhe të rrisë shpenzimet e kujdesit shëndetësor. Nëse një numër i madh i puntorëve shëndetësor marrin pushim mjekësor për shkak të gripit, mund të ketë ndërprerje në shërbimet e kujdesit shëndetësor, duke përfshirë reduktim të kapaciteteve të reagimit emergjent dhe ndihmës së shpejtë.



**VAKSINIMI KUNDËR GRIPIT ËSHTË
MËNYRA MË E MIRË PËR T'U
MBROJTUR NGA GRIPIT.**

**OBSh REKOMANDON VAKSINIMIN E
TË GJITHË PUNËTORËVE
SHËNDETËSOR KUNDËR GRIPIT
SEZONAL, PËR ÇDO VIT**

**VAKSINA KUNDËR GRIPIT ËSHTË E
SIGURT, ËSHTË APLIKUAR MË SHUMË
SE 60 VJET DHE DERI TANI NË BOTË
JANË VAKSINUAR MILIONA NJERËZ.**

**NËSE JENI PUNONJËS
SHËNDETËSOR VAKSINOHUNI
KUNDËR GRIPIT!**

**PUNONJËSIT SHËNDETËSOR
KANË RREZIK MË TË MADH PËR
T'U INFEKTUAR NGA GRIPIT**



Punonjësit shëndetësor kanë rrezik 10 herë më të madh për ta fituar gripin sesa popullata e përgjithshme, për shkak të natyrës së punës së tyre. Nëse jeni punonjës shëndetësor, mund ta fitoni gripin nga pacientët ose kolegët tuaj.

Sipas disa studimeve, është dëshmuar se gjatë një epidemie, në institucion shëndetësor, më shumë se gjysma e punonjësve shëndetësor që kujdesen për pacientët me grip janë vetë të infektuar me virusin. Gripi është një sëmundje serioze, mund të shkaktojë pneumoni, bronkit ose të përkeqësojë sëmundjet ekzistuese kronike shëndetësore. Vaksinimi kundër gripit për çdo vit është mënyra më e mirë për t'u mbrojtur nga gripit.

VAKSINOHUNI!



KUR JENI TË SËMURË ME GRIP, MUND TA TRANSMETONI GRIPIN TE PACIENTËT TUAJ

Ka studime që tregojnë se punonjësit shëndetësor mund ta transmetojnë gripin te pacientët e tyre, veçanërisht nëse ata janë të ndjeshëm ndaj zhvillimit të komplikimeve. Gripi është i rrezikshëm për fëmijët e vegjël, të rriturit dhe njerëzit me imunitet të dobësuar ose sëmundje të tjera kronike. Si rezultat i transmetimit të gripit nga punonjësi shëndetësor, disa pacientë mund të zhvillojnë komplikime të rrezikshme për jetën, siç janë rastet e dokumentuara të vdekjes nga gripit në qendrat e kujdesit intensiv neonatal dhe repartet e onkologjisë pediatrike.

GRIPË MUND TË JETË SËMUNDJE SERIOZE, TË SHKAKTOJË KOMPLIKIME DHE TË SJELLË DERI NË HOSPITALIZIM

**PUNONJËSIT SHËNDETËSOR
JANË TË PËRKUSHTUAR NDAJ PUNËS.
SHPESH SHKOJNË NË PUNË EDHE
PSE JANË TË SËMURË,
ME ÇKA E RRISIN RREZIKUN
E TRANSMETIMIT TË GRIPIT.**

Disa njerëz nuk shfaqin simptoma të gripit, kështu që ata mund të përhapin virusin e gripit pa e ditur se janë të infektuar, edhe pse nuk ndihen të sëmurë. Në një studim, gjysma e punonjësve shëndetësor me grip nuk e dinin se ishin bartës të virusit.

Mirëpo, nëse merrni vaksinën kundër gripit, mund të jeni të qetë sepse keni më pak gjasa të infektoni pacientët tuaj që janë të ndjeshëm.

MBRONI VETEN! MBRONI PACIENTËT TUAJ! MBRONI TË AFËRMIT TUAJ!

